

RAPORT

MONITORIMI I BUXHETIT TË
SHQIPËRISË PËR SHËNDETËSINË:

- VIT I PLOTË 2020
- SHTATOR – DHJETOR 2020
- JANAR – PRILL 2021

Të gjitha të drejtat në këtë dokument, përfshirë të drejtat e autorit, janë në pronësi të Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD) dhe mbrohen nga ligjet e zbatueshme të Mbretërisë së Bashkuar dhe ato ndërkombëtare. Ky dokument nuk mund të kopjohet, ndahet, përkthehet në një gjuhë tjetër, apo të përshtatet pa leje paraprake nga WFD.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të WFD-së, financuesve të saj apo Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. As WFD dhe as ndonjë person që vepron në emër të saj, nuk mund të mbahet përgjegjës për përdorimin që mund t'i jetë bërë informacionit që ai përmban.

NËNTOR 2021

PARATHËNIE.....	6
1. GJETJET KRYESORE, JANAR 2020 - PRILL 2021.....	7
2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	13
3. METODOLOGJIA DHE KUFIZIMET.....	16
4. SHPENZIMET TOTALE PËR SHËNDETËSINË.....	17
4.1 Vit i Plotë 2020.....	17
4.2 Periudha shtator - dhjetor 2020.....	19
4.3 Periudha janar - prill 2021	22
4.4 Zbatimi i programeve sipas zërave, janar - prill 2021.....	26
I. Planifikim, Menaxhim, Administrim	26
II. Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor	27
III. Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor	28
IV. Shërbime të Shëndetit Publik	29
V. Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore	30
VI. Përkujdesi Social.....	30
VII. Rehabilitimi i të përndjekurve politike	31
5. SHPENZIMET PËR PËRBALLIMIN E PANDEMISË	32
6. KOSTO E PLANIFIKUAR E MENAXHIMIT TË PANDEMISË NË 2021	37
7. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	45
BURIMET	47

Shkurtime

PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
FSDKSH	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
VKM	Vendime të Këshillit të Ministrave
QSUT	Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
QKUM	Qendra Kombëtare Urgjencës Mjekësore
PPP	Purchasing Power Parity (Barazia e fuqisë blerëse)
T I	Tremujori i parë
T II	Tremujori i dytë
T III	Tremujori i tretë
T IV	Tremujori i katërt
4MI	4-mujori i parë

Kursi mesatar i këmbimit: 1 Euro=123 lekë¹

¹Burimi: Banka e Shqipërisë

Lista e grafikëve

Grafiku 1: Shpenzimet publike për shëndetësinë

Grafiku 2: Shpenzimet totale buxhetore dhe shpenzimet për funksionet e shëndetësisë 2013-2021

Grafiku 3: Shpenzimet për shëndetësinë, sipas funksioneve, shtator-dhjetor, 2020-2021

Grafiku 4: Shpenzimet nominale për banor, shëndetësi (në Euro, sipas barazisë së fuqisë blerëse)

Grafiku 4.A Shpenzimet faktike, Ministria e Shëndetësisë, sipas programeve, 2019-2020

Grafiku 5: Shpenzimet sipas projekteve, Fakti i vitit 2020

Grafiku 6: Vdekjet, sipas tremujorëve (nr)

Grafiku 7: Shpenzimet sipas programeve, shtator-dhjetor 2020

Grafiku 8: Shpenzimet sipas programeve, Fakti, shtator - dhjetor 2020

Grafiku 9: Numri i vdekjeve Tremujori i parë 2021

Grafiku 10: Shpenzimet sipas projekteve, Fakti 4-mujori i 2021

Grafiku 11: Shpenzimet e shëndetësisë, sipas zërave të detajuar, programet kryesore, janar - prill 2021

Grafiku 12: Zbatimi faktik i Programit - Planifikim Menaxhim Administrimi, janar – prill 2021

Grafiku 13: Zbatimi i programit faktik Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor, janar – prill 2021

Grafiku 14: Zbatimi i programit faktik - Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor, janar – prill 2021

Grafiku 15: Zbatimi i programit faktik – shërbime të shëndetit publik, janar-prill 2021

Grafiku 16: Zbatimi i programit faktik – Përkujdesi social, janar-prill 2021

PARATHËNIE


Ky raport analizon realizimin e buxhetit të shëndetësisë për vitin 2020. Në analizë më të detajuar është marrë 4-mujori i fundit i vitit 2020 dhe 4-mujori i parë 2021, që është edhe periudha e fundit kur të dhënat zyrtare janë të disponueshme. Raporti analizon të dhënat zyrtare të përdorura nga Ministria e Financave për buxhetin faktik 2020 dhe planifikimin e buxhetit 2021, si dhe raportet e monitorimit të Ministrisë së Shëndetësisë që publikohen në bazë 4-mujore.

Gjithashtu janë shfrytëzuar të dhënat e prokurimeve në sektorin e shëndetësisë nga openprocurement.al. Krahas analizimit të të dhënave që janë publike, u dërguan kërkesa për informacion bazuar në ligji “Për Informimin Publik” në një sërë institucionesh.

1. GJETJET KRYESORE, JANAR 2020 - PRILL 2021

- Shqipëria prej dy vitesh është duke menaxhuar një pandemi të paprecedentë në 100 vitet e fundit, por ndryshe nga sa pritej, ajo nuk po ushtron presion të lartë mbi fondet publike, së paku në aspektin e fondeve shtesë që duhen për përballimin e krizës shëndetësore.
- Shpenzimet për sektorin e shëndetësisë në dy vitet e fundit (fakt 2020 - plan 2021) janë rritur me ritme më të ulëta se shpenzimet e përgjithshme buxhetore.
- Më 2021 buxheti i shtetit planifikon të shpenzojë 6.6 për qind nga shpenzimet totale buxhetore për financimin e sektorit të shëndetësisë (përfshirë fondet për mbrojtjen sociale), me një rënie 0.6 pikë përqindje në raport me vitin 2020 dhe niveli më i ulët në të paktën një dekadë, kur raportohen të dhënat. Ndonëse në vlerë nominale, shpenzimet e planifikuara për sektorin e shëndetësisë këtë vit janë rritur lehtë me 3.6% në krahasim me vitin 2020. Në raport me totalin e shpenzimeve, pesha e fondeve për shëndetësinë ka rënë ndjeshëm. Kjo ka ndodhur pasi qeveria e ka çuar rritjen e shpenzimeve totale buxhetore në sektorë të tjerë, si p.sh. infrastruktura.
- Në 2020, kur pandemia pllakosi vendin me dy valë të njëpasnjëshme në gusht dhe nëntor-dhjetor, sektori i shëndetësisë harxhoi vetëm 7.2 për qind të shpenzimeve totale buxhetore, me rënie prej 0.2 pikë përqindje në raport me vitin 2019.
- Siç shihet nga grafiku më poshtë, fondet për shëndetësinë kanë ardhur në rënie dy vitet e fundit, në raport me totalin e buxhetit të shtetit. Përgjatë dekadës së fundit, shpenzimet për shëndetësinë në raport me shpenzimet totale arritën kulmin në vitin 2014, me 7.7% të fondeve totale.

Grafiku 1: Shpenzimet për shëndetësinë




Burimi: Nga viti 2013-2019 shpenzimet në shëndetësi fakt (raportet e Monitorimit 2013-2020, Ministria e Shëndetësisë), buxhetet faktike (Ministria e Financave); 2021*, shpenzimet në shëndetësi planifikim; Përpunimi i të dhënave, Autori

- Nga marsi i vitit 2020 deri në qershor 2021, qeveria ka akorduar për përballimin e krizës shëndetësore që krijoi pandemia 10.1 miliardë lekë (82 milionë euro), nga të cilat 3.1 miliardë lekë (25.2 milionë euro) tashmë janë shpenzuar në buxhetin e vitit 2020 dhe 7 miliardë lekë (57 milionë euro) janë autorizuar për shpenzime gjatë këtij viti².
- Vlera e shpenzimeve për përballimin e pandemisë nga sistemi shëndetësor ishte sa 0.9% e shpenzimeve totale buxhetore të dy viteve të fundit.
- Gjatë vitit 2020, shpenzimet totale nga buxheti i shtetit ishin 536 miliardë lekë (4.3 miliardë euro), ndërsa në këtë vit plani i shpenzimeve buxhetore sipas Aktit Normativ nr.26 datë 22.06.2021 do të jenë 610 miliardë lekë (5 miliardë euro). Shpenzimet totale buxhetore në dy vitet së bashku 2020 dhe 2021 arrijnë një vlerë të përgjithshme rreth 1.1 triliardë lekë ose 9,3 miliardë euro. Fondet për përballimin e krizës shëndetësore përgjatë 2020 - Plan 2021, prej

²<https://www.financa.gov.al/projektbuxheti-2021/relacioni>

rreth 82 milionë eurosh, janë vetëm 0.9% e vlerës totale të shpenzimeve buxhetore prej 9,3 miliardë euro³.

Grafiku 2: Shpenzimet totale buxhetore dhe shpenzimet për funksionet e shëndetësisë 2013-2021



Burimi: <https://financa.gov.al/statistika-fiskale-mujore/>; <https://shendetesia.gov.al/tabelat-e-raportimit-per-intervalet-kohore-3-muaj-9-muaj-dhe-vjetore-si-dhe-relacionet-perkatese/>; 2021* - plan

- Shpenzimet për përballimin e pandemisë në aspektin shëndetësor pritet të jenë sa 12,6% e totalit të buxhetit të sektorit të shëndetësisë për dy vitet 2020 - plan 2021.
- Edhe në kulmin e valës pandemike në shtator - dhjetor 2020⁴, shpenzimet për shëndetësinë pësuan rritje të vakët. Fondet për sektorin në këtë periudhë ishin vetëm 12% më të larta se e njëjta periudhë në vitin normal 2019 (shih grafikun më poshtë). Gjatë muajve tetor - dhjetor vdekjet totale në vend u rritën me 70%, në krahasim me mesataren e të njëjtës periudhë për 2016 -2019.
- Nga fondet e dedikuara për krizën shëndetësore në vitin 2020, shihet se një pjesë e madhe e tyre shkuan për pajisje mbrojtëse për stafet mjekësore dhe shumë pak për të përmirësuar logjistikën dhe shërbimet


³<https://financa.gov.al/statistika-fiskale-mujore/>

⁴TfL e ka analizuar në raportin e mëparshëm realizimin e buxhetit të shëndetësisë për periudhën janar-gusht 2020

ndaj pacientëve. Nga 3.1 miliardë lekë (25 milionë euro), 1,2 miliardë lekë (9,6 milionë euro) ose 38% e totalit shkuan për mjete mbrojtëse, ndërsa pjesa tjetër për përmirësimin e infrastrukturës dhe logjistikës në spitalet COVID.

- Ky raport është vazhdim i punës së bërë më parë për analizimin e buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë. Duke qenë se raporti i mëparshëm analizon periudhën 9-mujore të vitit 2020, në raportin aktual është bërë një përmbledhje të gjithë vitit 2020. Në analizë më të detajuar është marrë 4-mujori i fundit i vitit 2020 dhe 4-mujori i parë 2021, që është edhe periudha e fundit kur të dhënat zyrtare janë të disponueshme. Lexo raportin: Në gjurmët e parave të COVID-19, rasti i Shqipërisë⁵

Grafiku 3: Shpenzimet për shëndetësinë sipas funksioneve, shtator – dhjetor 2020-2021



- E njëjta ecuri u vu re edhe gjatë 4-mujorit të parë (4 M I) 2021. Edhe pse pati një shtim të rasteve me COVID-19 në periudhën janar - shkurt 2021 dhe gjithnjë e më shumë fonde duheshin për blerjen e vaksinave, buxheti i shpenzuar për shëndetësinë ishte 15 miliardë lekë (122 milionë euro), me një rritje 33% në raport me 4 mujorin e parë (4 M I) 2020.


⁵https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2021/01/WFD-Report_Follow-the-Money_Shendetesi_Shqip-FINAL.pdf?

	Realizimi faktik M I 2020 (mijë lekë)	Realizimi faktik 4 M I 2021 (mijë lekë)	Ndryshimi në %, 2021/2020
Planifikim, Menaxhim, Administrim	267,239	66,637	-75.1
Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor	2,908,039.50	3,054,645	5.0
Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor	7,174,841	9,134,984	27.3
Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore	50,140	81,476	62.5
Shërbime të Shëndetit Publik	828,677	2,669,616	222.2
Totali	11,228,937	15,007,358	33.6

Të dhëna të tjera të EUROSTAT tregojnë se shpenzimet për shëndetësinë në Shqipëri janë ndër më të ulëtat në Evropë dhe kjo tendencë vijoi edhe në vitin pandemik 2020. Shpenzimet nominale për banor në sektorin e shëndetësisë⁶, të matura në euro, sipas barazisë së fuqisë blerëse, ishin 297 euro në vitin 2020, e dyta më e ulët në Evropë pas Maqedonisë së Veriut (255 euro) dhe shumë më e ulët sesa mesatarja e Bashkimit Evropian (27 vende) prej 2,614 euro.

⁶https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/PRC_PPP_IND__custom_1303701/default/table?lang=en

Grafiku 4: Shpenzimet nominale për banor, shëndetësi (në Euro, sipas barazisë së fuqisë blerëse)



BURIMI: EUROSTAT

2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Viti 2020⁷

Ashtu si në të gjithë botën, shpërthimi i pandemisë së COVID-19 pati një efekt mbizotërues në Shqipëri, si në ekonomi ashtu dhe në menaxhimin e situatës së shëndetit të popullatës.

Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) nominale arriti në 1,607.9 miliardë lekë⁸ (13 miliardë euro) në fund të vitit 2020, duke u tkurrur me 3.3% krahasuar me vitin 2019 dhe shënuar nivelin më të ulët që nga kriza e piramidave në vitin 1997. Ky është recesioni i parë në Shqipëri për më shumë se dy dekada, por ekonomia shqiptare dëshmoi qëndrueshmëri dhe rënia ekonomike rezultoi shumë më e përmbajtur se sa parashikimi fillestar, i cili luhatej midis -6.1% dhe -8% në vit.

Që nga 9 marsi 2020, kur në Shqipëri u identifikua rasti i parë zyrtar i infektuar me COVID-19, i ndjekur nga masa të rrepta kufizuese për të frenuar përhapjen e pandemisë, financat publike u vunë në presion me tkurrjen e të ardhurave, rritjen e shpenzimeve dhe rritjen e borxhit. Gjatë vitit 2020, të ardhurat ranë me 7.5% në raport me faktin e 2019-s. Në kahun tjetër, shpenzimet u rritën me 9% si rrjedhojë e paketave për të ndihmuar ekonominë dhe ri-orientimit të shpenzimeve në shëndetësi për të përballuar pasojat e pandemisë. Rënia e të ardhurave dhe rritja e shpenzimeve ndikuan në rritjen me 250% të deficitit buxhetor⁹.

Buxheti total faktik i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), përfshirë fondet për Kujdesin Social, në vitin 2020 ishte 67,6 miliardë lekë (549 milionë euro), me një rritje prej 10.4% në raport me vitin e kaluar¹⁰. **Në vitin 2020, shpenzimet për sektorin e shëndetësisë zunë 12.6% e shpenzimeve totale buxhetore, nga 12.4% që ishte kjo peshë në 2019-n, kur ishte një vit normal¹¹. Ndryshimi i papërfillshëm i peshës së shpenzimeve në shëndetësi në vitin e pandemisë është një tregues se rritja e fortë e deficitit buxhetor nuk u orientua në përballimin e emergjencës shëndetësore.**

Nga totali i fondeve që u akorduan nga qeveria shqiptare për përballimin e efekteve pandemike në ekonomi e shëndetësi, prej 16.5 miliardë lekësh (143 milionë euro), vetëm 3.1 miliardë lekë (24 milionë euro), ose 19%, u përdorën për financimin e

⁷Ky raport është vazhdim i punës së bërë më parë për analizimin e buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë. Duke qenë se raporti i mëparshëm analizon periudhën 9 muajore të vitit 2020, në raportin aktual është bërë një përmbledhje e gjithë vitit 2020. Në analizë më të detajuar është marrë 4 mujori i fundit i vitit 2020 dhe 4 mujori i parë 2021, që është dhe periudha e fundit kur të dhënat zyrtare janë të disponueshme. Raportin e mëparshëm e gjeni në link: https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2021/01/WFD-Report-Follow-the-Money_Shendetesi_Shqip-FINAL.pdf?fbclid=IwAR0f6S2AkN_gzIBkeg4cGurtAXLXnJD-1rgyW35NQfoCyHzAWnc1nV7-mBQ

⁸<http://www.instat.gov.al/al/temat/ekonomi-dhe-financ%C3%AB/llogarit%C3%AB-komb%C3%ABtare-gdp/publikimet/2021/produkti-i-brendsh%C3%ABm-bruto-t1-2021/>

⁹<https://financa.gov.al/statistika-fiskale-mujore/>

¹⁰<https://shendetesia.gov.al/tabelat-e-raportimit-per-intervalet-kohore-3-muaj-9-muaj-dhe-vjetore-si-dhe-relacionet-perkatese/>

¹¹<https://financa.gov.al/statistika-fiskale-mujore/>

nevojave shëndetësore që krijoi pandemia, ndërsa 13,5 miliardë lekë (110 milionë euro) u përdorën për mbështetje të ekonomisë nëpërmjet dy paketave të ndihmës¹².

Për periudhën shtator - dhjetor 2020, që përkon me ashpërsimin e valës së parë të pandemisë, shpenzimet faktike në shëndetësi, përfshirë fondet për Mbrojtjen Sociale, ishin 24,8 miliardë lekë (195 milionë euro), me një rritje prej 14% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, e ndikuar nga shtimi i ndjeshëm i shpenzimeve për përkujdesin social, të cilat nuk janë të lidhura direkt me shpenzimet shëndetësore, po janë pagesa që u bëhen familjeve në nevojë. Nga shuma 195 milionë euro e shpenzuar në shtator - dhjetor 2020, 9,1 miliardë lekë (74 milionë euro) ose 36.8% ishin fonde për përkujdesin social dhe 15,6 miliardë lekë (126,8 milionë euro) ose 63.1% ishin shpenzime për shëndetësinë. Në vitin 2017 funksioni i mbrojtjes sociale kaloi në MSHMS.

Pjesa e parë e 2021

Edhe në pjesën e parë të vitit 2021, vendi u përball me një valë të dytë të fortë pandemie. Pavarësisht kësaj vale dhe rritjes së lartë të vdekshmërisë shtesë¹³ me 70%¹⁴ në raport me periudhat normale, qeveria nuk ndërmori vendime të ashpra për karantinë, duke zgjedhur ekonominë përpara shëndetit të popullatës. Mungesa e kufizimeve çoi në përmirësimin e ekonomisë. Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) në tremujorin e parë të vitit 2021 vlerësohet me rritje prej 5.53%, kundrejt tremujorit të parë të vitit 2020.¹⁵

Përmirësimi i ekonomisë në pjesën e parë të vitit 2021 ndikoi në rishikimin në rritje të buxhetit të shtetit në vitin aktual. Me aktin normativ **Akti Normativ Nr.26 datë 22.06.2021** për ndryshimin e buxhetit 2021, plani i të ardhurave u rishikua me 1% rritje në raport me buxhetin fillestar, duke arritur në 489 miliardë lekë (3,97 miliardë euro), ose 13% më i lartë se fakti i vitit 2020¹⁶.

Plani i shpenzimeve buxhetore në qershor 2021 u rrit me 17 miliardë lekë (138 milionë euro), duke arritur një total prej 610 miliardë lekësh (4,9 miliardë euro) ose 2.9% më shumë se plani i fillimit të vitit 2021, ndërsa deficitin buxhetor u zgjerua me 11.8 miliardë lekë (95,9 milionë euro) në raport me buxhetin e fillimit të vitit, duke arritur vlerën e 120,5 miliardë lekëve (101 milionë euro) ose 11% më shumë se limiti në ligjin fillestar të buxhetit të vitit 2021. Shpenzimet totale në buxhetin e vitit 2021 do të jenë 12.2% më të larta se fakti i 2020.

¹²<https://financa.gov.al/paketa-e-projektligjit-te-buxhetit-faktik-2020/>

¹³Vdekshmëria shtesë (excess death/mortality) është një term i përdorur në epidemiologji dhe shëndetin publik që i referohet numrit të vdekjeve nga të gjitha shkaqet gjatë një periudhe krize që është mbi dhe përtej asaj që do të pritej në kushte normale. <https://ourworldindata.org/excess-mortality-covid>

¹⁴<http://instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martesat/publikimet/2020/treguesit-demografik%C3%AB-t4-2020/>

¹⁵<http://www.instat.gov.al/al/temat/ekonomi-dhe-financ%C3%AB/llogarit%C3%AB-komb%C3%ABtare-gdp/#tab3>

¹⁶<https://financa.gov.al/ep-content/uploads/2021/06/Akti-Normativ-i-Buxhetit-2021-nr.26-date-22.06.2021.pdf>

Pavarësisht rritjes totale të shpenzimeve, sipas ndryshimeve të fundit të buxhetit, fondet totale për Ministrinë e Shëndetësisë arritën në 70,4 miliardë lekë (572 milionë euro) nga 71,4 miliardë (580 milionë euro) që ishin në buxhetin fillestar, duke rënë lehtë me 1.4%, ndonëse pandemisë ende nuk po i duket fundi.

Për periudhën janar - prill 2021, shpenzimet totale të shëndetësisë ishin 24,1 miliardë lekë¹⁷ (196 milionë euro), me një rritje prej 13.5% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rritja u udhëhoq nga shtimi i shpenzimeve të “Shërbimit Kombëtar të Urgjencës Mjekësore” dhe “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor”.

Gjatë 4-mujorit të parë 2021 u përdorën 1,4 miliardë lekë (11,3 milionë euro) fonde buxhetore për blerjen e vaksinave anti-COVID, kryesisht Pfizer dhe Sinovac¹⁸. 430 milionë lekë (3,5 milionë euro)¹⁹ u prokuruan në janar 2021 për parapagimin e një pjese nga 500 mijë dozat Pfizer, teksa për të gjithë vitin 2021 fondi në dispozicion për blerjen e vaksinave Pfizer është 2 miliardë lekë (16,3 milionë euro).

Për vitin 2021, nga Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit për vitin 2021, në muajin janar janë akorduar fonde në vlerën **430 milionë lekë (3,5 milionë euro)**, për parapagimin e dozave të vaksinës Pfizer. Shpenzimet për Urgjencën Mjekësore në 4-mujorin e parë 2021 ishin 81,4 milionë lekë (661 mijë euro) ose 23 % e planit vjetor²⁰. Kjo vlerë ishte 62% më e lartë se 4-mujori i parë i vitit 2020. Pothuajse e gjitha shuma e shpenzuar për Urgjencën Kombëtare ishte për rastet e trajtuara nga njësitë e urgjencës. Fondet e shpenzuara për Urgjencën Kombëtare në 4-mujorin e parë përfaqësonin vetëm 0.4 për qind të buxhetit total të Ministrisë së Shëndetësisë për këtë periudhë.

Gjatë periudhës janar - prill 2021, shpenzimet për kujdesin shëndetësor dytësor ishin 9,1 miliardë lekë (74 milionë euro) ose 52% e fondeve vjetore të planifikuara. Kjo shumë ishte 22% më e lartë se shpenzimet e 4-mujorit të parë 2020 për shërbimin dytësor.

Spitalet publike kanë shpenzuar gjithsej shumën 7.5 miliardë lekë (61 milionë euro), ose 38% e fondeve vjetore të planifikuara për këtë shërbim. Numri i personave të shtruar në spitalet e financuara nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FDSKSH) për periudhën 4-mujore është 73,556 pacientë. Gjatë kësaj periudhe spitalet kanë shpërblyer personelin e tyre me mbi 210 milionë lekë (1,7 milionë euro) në muaj si bonus për angazhimin në vijën e parë ndaj pandemisë. Kjo pagesë ka rënduar situatën financiare, pasi vetëm për 4 muajt e parë është shpenzuar e 38% e shumës vjetore. Ministria e Shëndetësisë ka lajmëruar se nevojat shtesë për këtë zë janë mbi 1,1 miliardë lekë (9 milionë euro) këtë vit.²¹

¹⁷Përfshirë fondet e Mbrojtjes Sociale

¹⁸Ministria e Shëndetësisë/Raporti i Monitorimit të buxhetit - 4 muajori i parë 2021
<http://openprocurement.al/sq/htender/view/id/25917>

²⁰Ministria e Shëndetësisë/Raporti i Monitorimit të buxhetit - 4 muajori i parë 2021

²¹Ministria e Shëndetësisë/Raporti i Monitorimit 4-mujori i parë 2021/ E drejta e informimit

3. METODOLOGJIA DHE KUFIZIMET

Për hartimin e këtij raporti janë përdorur të dhënat zyrtare nga Ministria e Financave për buxhetin faktik 2020 dhe planifikimin e buxhetit 2021, si dhe raportet e monitorimit të Ministrisë së Shëndetësisë që publikohen në bazë 4-mujore. Raporti fokusohet në 4-mujorin e fundit 2020 dhe 4-mujorin e parë 2021, që përkon me valën e parë dhe të dytë të pandemisë, me pasoja të rënda në humbjen e jetëve njerëzore.

Në raport bëhet dhe një përmbledhje e gjithë vitit 2020, pasi raporti i mëparshëm mbulonte vetëm periudhën 9-mujore.

U përdoren gjithashtu të dhënat e prokurimeve në sektorin e shëndetësisë nga openprocurement.al.

Krahas analizimit të të dhënave që janë publike, u dërguan kërkesa për informacion bazuar në ligji “ Për Informimin Publik”²² në një sërë institucionesh, si Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Bashkëpunimi i institucioneve për të bërë transparencë mbi shpenzimet buxhetore, sidomos ato të lidhura me pandeminë, ishte minimal, duke kthyer përgjigje të vakëta, apo duke mos u përgjigjur fare. Deri në momentin e publikimit të këtij raporti, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale iu përgjigj në mënyrë të pjesshme kërkesës për informacion, për efekt të këtij raporti, duke mos dhënë detaje për blerjen e detajuar të pajisjeve, kostot spitalore për trajtimin e një patienti me simptoma të rënda të COVID-19, apo mbulimin e kostove të trajtimeve të të sëmurëve në shtëpi.

²²<https://www.idp.al/freedom-of-information/?lang=en>

4. SHPENZIMET TOTALE PËR SHËNDETËSINË

4.1 Viti 2020

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale administron dhe menaxhon fondet publike sipas shtatë programeve të miratuara, si vijon:


1. Planifikim, menaxhim, administrim; materiale mbrojtëse për COVID-19; bonus për mjekë; blerje autoambulancash, pajisje mjekësore etj.)
2. Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor
3. Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor
4. Shërbime të Shëndetit Publik
5. Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore
6. Përkujdesi Social (pagesa cash për familjet në nevojë, individët me aftësi të kufizuar dhe bonusi i bebeve)
7. Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë

Për vitin 2020, shpenzimet totale faktike për shëndetësinë ishin 67,5 miliardë lekë (549 milionë euro), me një rritje prej 10.4% me bazë vjetore²³. Rritja u udhëhoq nga shtimi i shpenzimeve për “Përkujdesin Social” me 18% (+4.2 miliardë lekë ose 34 milionë euro) dhe për planifikim, menaxhim dhe administrim, që u gjashtëfishuan (+1.85 miliardë lekë ose 14,6 milionë euro).

Nëse shpenzimet totale të MSHMS do të zhvishen nga shërbimet e kujdesit social dhe rehabilitimi i të përndjekurve, që nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me kujdesin shëndetësor, fondi total për “Planifikim, menaxhim, administrim”, “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor”, “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor”, “Shërbime të Shëndetit Publik”, “Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore” për vitin 2020 rezultoi 38,7 miliardë lekë (314,6 milionë Euro) në vitin 2020, me rritje 6.5% me bazë vjetore.

²³<https://shendetesia.gov.al/tabelat-e-raportimit-per-intervalet-kohore-3-muaj-9-muaj-dhe-vjetore-si-dhe-relacionet-perkatese/>


Grafiku 4 A: Shpenzimet faktike, Ministria e Shëndetësisë sipas programeve 2019-2020



Burimi: <https://shendetesia.gov.al/tabelat-e-raportimit-për-intervalet-kohore-3-muaj-9-muaj-dhe-vjetore-si-dhe-relacionet-përkatëse/>

“Përkujdesi Social” zë pjesën më të madhe të shpenzimeve të shëndetësisë, me 41.1% të totalit për vitin 2020. Në krahasim me vitin e mëparshëm, ka një rritje me 2.6 pikë përqindje. Programi i dytë është “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor”, që përfshin shpenzimet ndaj spitaleve publike me 38.1% të totalit, i ndjekur nga “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor” (11.4%).

Grafiku 5: Shpenzimet sipas projekteve, fakti i vitit 2020



Burimi: Ministria e Shëndetësisë, raportet e monitorimit

4.2 Periudha shtator - dhjetor 2020


Katër mujori i fundit i vitit 2020 përkon me valën e parë të pandemisë COVID-19, e cila kulmoi në muajt nëntor dhe dhjetor. Rritja e ndjeshme e rasteve të infektiveve me COVID-19 çoi në shtim të mbingarkesës në spitale dhe rritje të lartë të vdekshmërisë shtesë në vend. Në periudhën tetor - dhjetor, vdekjet u rritën me 70% në krahasim me mesataren e të njëjtës periudhë për 2016 - 2019²⁴, ose rreth 3,900 jetë të humbura më shumë. Vdekshmëria e lartë shtesë në krahasim me mesataren e 2016 - 2019, është një tregues i pasojave të rënda që ka sjellë COVID-19 në shëndetin e popullatës dhe rritjen e numrit të jetëve të humbura, që në një situatë normale jo-pandemike nuk do të kishte ndodhur.

Të dhëna të fundit nga Komisioni Evropian²⁵ konfirmojnë se Shqipëria kishte rritjen më të lartë të vdekshmërisë shtesë në Evropë gjatë vitit 2020, me 27% më shumë fatalitete, në krahasim me mesataren e 2016-2019.

²⁴<http://instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martesat/publikimet/2020/treguesit-demografik%C3%AB-t4-2020/>

²⁵<https://www.esap.online/observatory/docs/148/social-protection-and-inclusion-policy-responses-to-the-covid-19-crisis>

Grafiku 6: Vdekjet, sipas tremujorëve (Nr)



Burimi: INSTAT

Për periudhën shtator - dhjetor 2020, shpenzimet faktike në shëndetësi ishin 24,8 miliardë lekë (201 milionë euro), me një rritje prej 14% (+3 miliardë lekë ose 24 milionë euro) në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rritja u ndikua në pjesën më të madhe nga shtimi i shpenzimeve për programin “Përkujdesi Social”, me 17.2% ose +1,33 miliardë lekë (10,5 milionë euro). Ky program mbështet nëpërmjet pagesave në cash dhe shërbimeve sociale familjet në nevojë dhe individët me aftësi të kufizuara, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe mundësive personale, për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara social-ekonomike. Përgjatë gjithë vitit të kaluar, 66,650 mijë familje u trajtuan me ndihmë ekonomike nga 62,523 familje që morën ndihmë ekonomike më 2019. Pandemia rriti numrin e të papunëve dhe, për rrjedhojë, mbi 4 mijë familje u futën rishtas në skemën e ndihmës ekonomike më 2020²⁶.

Nëse shpenzimet totale të MSHMS do të zhvishen nga shërbimet e kujdesit social dhe rehabilitimin e të përndjekurve, që nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me kujdesin shëndetësor, fondi total për “Planifikim, Menaxhim, Administrim”, “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor”, “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor”, “Shërbime të Shëndetit Publik”, “Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore” rezultoi


²⁶<https://shendetesia.gov.al/tabelat-e-raportimit-per-intervalet-kohore-3-muaj-9-muaj-dhe-vjetore-si-dhe-relacionet-perkatese/>

15.8 miliardë lekë (158 milionë euro) në periudhën shtator - dhjetor 2020, me rritje 11.9% me bazë vjetore, në raport me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Fondet për “Planifikim, Menaxhim, Administrim” (që përfaqësojnë shpenzimet për furnizimet që kanë të bëjnë me përballimin e pandemisë COVID-19), në shtator - dhjetor 2020 u pesëfishuan (+0.9 miliardë lekë, ose 7,3 milionë Euro). Pjesa më e madhe prej 325 milionë lekësh (2.6 milionë euro) shkoi për blerjen e materialeve mbrojtëse në ndihmë të stafëve mjekësore kundër COVID-19, ndërsa rritja në këtë zë u stimulua edhe nga pagesa e bonusit për mjekët në vlerën 18,4 milionë lekë (149 mijë euro), që nisi të paguhej në 4-mujorin e fundit të vitit 2020. Në këtë periudhë u blenë edhe 229,8 milionë lekë (1,8 milionë euro) autoambulanca dhe 116 milionë lekë (943 mijë euro) pajisje mjekësore të kategorisë së parë.

Në dyfishim ishin edhe shpenzimet për shërbimin kombëtar të urgjencës mjekësore.


Grafiku 7: Shpenzimet sipas programeve, shtator-dhjetor



Burimi: Ministria e Shëndetësisë, raportet e monitorimit

“Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor” zuri pjesën më të madhe të shpenzimeve të shëndetësisë, me 43% të totalit për shtator - dhjetor 2020. Programi i dytë është “Përkujdesi Social”, me 37% të totalit, i ndjekur nga “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor” (9%).

Grafiku 8: Shpenzimet sipas programeve, fakti shtator-dhjetor 2020




Burimi: Ministria e Shëndetësisë, raportet e monitorimit

4.3 Periudha janar - prill 2021

Muajt e parë të vitit 2021 vijuan të jenë të vështirë, pasi një valë e dytë e pandemisë, që ishte më e fortë në shkurt dhe mars, pushtoi vendin. Në mungesë të kufizimeve të ashpra, përhapja e saj ishte e gjerë, duke shkaktuar sërish mbingarkesë në spitale dhe një rritje të lartë të vdekshmërisë shtesë. Për periudhën janar - mars 2021, vdekjet u rritën me 53%, në krahasim me mesataren e 2016 - 2019²⁷ (ose rreth 3,300 jetë të humbura më shumë). Mbingarkesa në spitale ndikoi shpenzimet e programit “Shërbime të Kujdesit Dytësor”.

²⁷<http://instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martesat/publikimet/2021/treguesit-demografik%C3%AB-t1-2021/>

Grafiku 9: Numri i vdekjeve, tremujori i parë



Burimi: INSTAT

Për periudhën janar - prill 2021, shpenzimet totale të shëndetësisë ishin 24,1 miliardë lekë (197 milionë euro), me një rritje prej 13.5% (+2,9 miliardë lekë ose 18,6 milionë Euro), në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Nëse shpenzimet totale të MSHMS do të zhvishen nga shërbimet e kujdesit social dhe rehabilitimi i të përndjekurve, që nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me kujdesin shëndetësor, Fondi total për “Planifikim, menaxhim, administrim”, “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor”, “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor”, “Shërbime të Shëndetit Publik”, “Shërbimi Kombëtar i i Urgjencës Mjekësore” rezultoi 11,2 miliardë lekë (91 milionë Euro) në periudhën janar - prill 2021, me rritje 33.6% me bazë vjetore, në raport me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Rritja në 4-mujorin e parë të vitit u ndikua nga shtimi i ndjeshëm i shpenzimeve të programit “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor”, me 27.3% (+1,96 miliardë lekë, ose 15,9 milionë euro) dhe “Shërbime të Shëndetit Publik”, që u trefishuan (+1,84 miliardë lekë ose 15 milionë euro). Kjo rritje në këto zëra u ndikua më së shumti nga fondet për trajtimin e 73,566 pacientëve në spitale dhe për vaksinat anti-COVID me vlerë 1,4 miliardë lekë (11,3 milionë euro).

Shpenzimet, sipas projekteve (mijë lekë)					
	Fakti 4 M I 2018	Fakti 4 M I 2019	Fakti 4 M I 2020	Fakti 4 M I 2021	Ndryshimi ne %, 2021/2020
Planifikim Menaxhim Administrim	100,838	80,373	267,239	66,637	-75.1
Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor	2,744,874	3,191,059	2,908,039.50	3,054,645	5.0
Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor	6,070,240	6,943,495	7,174,841	9,134,984	27.3
Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore	47,889	39,278	50,140	81,476	62.5
Shërbime të Shëndetit Publik	866,868	891,058	828,677	2,669,616	222.2
Përkujdesi Social	6,359,955	7,294,808	9,541,050	8,789,166	-7.9
Rehabilitimi i të përndjekurve politike	149,099	423,048	431,883	269,751	-37.5
Totali	16,339,763	18,863,119	21,201,870	24,073,332	13.5
<i>Burimi: Ministria e Shëndetësisë, raportet e monitorimit</i>					

“Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor” zuri pjesën më të madhe të shpenzimeve të shëndetësisë, me 38% të totalit për 4-mujorin e parë 2021. Programi i dytë është “Përkujdesi Social”, me 37% të totalit, i ndjekur nga “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor” (13%).

Grafiku 10: Shpenzimet sipas projekteve, fakti 4 mujori i 2021



Burimi: Ministria e Shëndetësisë, raportet e monitorimit


Sipas zërave të detajuar, rritja e shpenzimeve të shëndetësisë në 4-mujorin e parë të 2021 është ndikuar nga trajtimi i 73,556 pacienteve të shtruar në spitale, që përbënte 34% të totalit të shpenzimeve të shëndetësisë për periudhën në fjalë, nga 26.7% për 4-mujorin 2020, si rrjedhojë e numrit të lartë të pacientëve të infektuar me COVID-19 që ndikuan rritjen e shpenzimeve në Programin e Kujdesit Shëndetësor Dytësor.

Për trajtimin e pacientëve të shtruar në spitale u shpenzuan për janar - prill rreth 8,2 miliardë lekë (67 milionë euro), me rritje prej 45%, ose 2,5 miliardë lekë (20,3 milionë euro) më shumë.

Një zë i ri që ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve të shëndetësisë është ai për vaksinimin e popullatës me qëllim imunizimin ndaj COVID-19, me një buxhet faktik prej 1,4 miliardë lekë (11,3 milionë euro) për 4-mujorin e parë 2021.

Në rritje ishte dhe buxheti për vizitat në kujdesin shëndetësor parësor, pothuajse dyfish, dhe kjo e lidhur me valën e fortë të pandemisë së COVID-19.

Grafiku 11: Shpenzimet e shëndetësisë sipas zërave të detajuar, programet kryesore janar-prill



Burimi: Ministria e Shëndetësisë, raportet e monitorimit²⁸

4.4 Zbatimi i programeve sipas zërave, janar - prill 2021


I. Planifikim, Menaxhim, Administrim

Shpenzimet për këtë program ishin 66,6 milionë lekë (536,500 euro) për janar - prill 2021, me një tkurrje prej 75% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rënia ka ardhur pasi nuk u zbatuan zërat për shpenzimet për materialet mbrojtëse të COVID. Në këtë zë përfshihen shpenzimet për miratimin e akteve ligjore, bonusi i mjekëve që u përballen me pandeminë, materialet mbrojtëse kundër COVID-19, blerjen e pajisjeve mjekësore etj. Në këtë zë ishin parashikuar për miratimin e akteve ligjore. Shpenzimet që kishin lidhje me furniturën e kundër COVID-19 shënuan ulje

²⁸Shënim: Në grafik nuk janë përfshirë programet për "Persona me aftësi të kufizuar", "Bonusi i Bebeve" dhe "Familje dhe individë në nevojë që përfitojnë nga skema e Ndihmës Ekonomike" pasi, ndonëse janë në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë (siç është sqaruar më sipër), nuk lidhen direkt me programet e shëndetësisë.

në 4-mujorin e parë të 2021, në raport me të njëjtën periudhë të vitit 2020, ku shpenzimet për blerjen e tyre ishin të larta.

Grafiku 12: Zbatimi faktik i programit – planifikim menaxhim administrimi, Janar - Prill




Burimi: Ministria e Shëndetësisë, raportet e monitorimit

II. Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor

Shpenzimet për këtë program ishin 3 miliardë lekë (24 milionë Euro) për janar - prill 2021, me një rritje prej 5% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rritja është ndikuar tërësisht nga dyfishimi i numrit të vizitave në Kujdesin Shëndetësor Parësor, si rrjedhojë e kulmimit të pandemisë.

Shpenzimet për persona që përfitojnë check-up ishin zero, për shkak të ndërprerjes së këtij shërbimi pas pandemisë. Në rënie me 19% ishin dhe shpenzimet për pacientë të trajtuar me recetë me rimbursim nga mjeku i familjes.

Grafiku 13: Zbatimi i programit faktik shërbime të kujdesit shëndetësor parësor, Janar-Prill




Burimi: Ministria e Shëndetësisë, raportet e monitorimit

III. Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor

Shpenzimet për shërbimet e kujdesit shëndetësor dytësor u rritën me 27.3% me bazë vjetore në janar - prill 2021, duke arritur në 9,1 miliardë lekë (74 milionë euro).

Ky zë u ndikua tërësisht nga shtimi i trajtimit të pacientëve në spitale, që arriti në 8,2 miliardë lekë (66 milionë euro), ose 45% më shumë se 4-mujori i parë i 2020-s, si rrjedhojë e mbingarkesës që shkaktoi vala e dytë e pandemisë.

Grafiku 14: Zbatimi i programit faktik- shërbime të kujdesit shëndetësor dytësor, Janar - Prill




Burimi: Ministria e Shëndetësisë, raportet e monitorimit

IV. Shërbime të Shëndetit Publik

Shpenzimet faktike për programin e “Shërbime të Shëndetit Publik” ishin gati 2,7 miliardë lekë (21 milionë euro) për 4-mujorin e parë 2021, duke u trefishuar në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo rritje ka ardhur si rrjedhojë e shtimit në këtë program të buxhetit për vaksinimin e popullatës kundër COVID-19, që ka për qëllim imunizimin e popullatës. Shpenzimet për personat e vaksinuar me vaksinën anti-COVID rezultuan 1,4 miliardë lekë (8,9 milionë euro), nga 1,47 miliardë lekë (9 milionë euro) që ishte buxheti vjetor i planifikuar për këtë zë.

Grafiku 15: Zbatimi i programit faktik – shërbime të shëndetit publik, Janar-Prill



Burimi: Ministria e Shëndetësisë, raportet e monitorimit (të dhënat në mijë lekë)

V. Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore


Shpenzimet faktike për këtë program ishin 81,5 milionë lekë (662 mijë euro), me një rritje prej 62.5% për zërin raste të trajtuara nga njësitë e urgjencës mjekësore. Të gjitha fondet e urgjencës që u shpenzuan në 4-mujorin e parë 2021 shkuan për trajtimin e 337,500 rasteve nga njësitë e urgjencës mjekësore.

VI. Përkujdesi Social

Ky program mbështetet nëpërmjet pagesave në cash dhe shërbimeve sociale, familjet në nevojë dhe individët me aftësi të kufizuara, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe mundësive personale, për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara social ekonomike dhe zbatohet nga Ministria e Shëndetësisë.

Zbatimi faktik i këtij programi ishte 8,8 miliardë lekë (71 milionë euro) për 4-mujorin e parë 2021, me një tkurrje prej 8% nga janar - prill 2020, si rrjedhojë e uljes me 19% të pagesave për Persona me Aftësi të Kufizuara - PAK dhe kujdestarëve që përfitojnë pagesa.

Grafiku 16: Zbatimi i programit faktik – Përkujdesi social, Janar-Prill



Burimi: Ministria e Shëndetësisë, raportet e monitorimit

VII. Rehabilitimi i të përndjekurve politike

Ky program synon integrimin e ish të Përndjekurve Politike nga regjimi komunist në jetën e shoqërisë shqiptare. Pagesat e dëmshpërblimit të ish-dënuarve politik për 4-mujorin 2021 ishin 270 milionë lekë (2,2 milionë Euro, zbatimi faktik), me rënie 37.5% me bazë vjetore. Edhe në periudha normale, në vite jo-pandemike ish të përndjekurit nuk arrijnë të marrin fondet e programuara për shkak se në shumë raste nuk përmbushin kushtet dhe dokumentacionin përkatës.

5. SHPENZIMET PËR PËRBALLIMIN E PANDEMISË

SHPENZIMET TOTALE PËR PËRBALLIMIN E EFEKTEVE TË PANDEMISË VETËM 3.1% E BUXHETIT 2020

Gjatë vitit 2020 shpenzimet buxhetore për përballimin e efekteve që krijoi pandemia COVID-19 në ekonomi dhe në sektorin e shëndetësisë arritën në 16,5 miliardë lekë ose 134,8 milionë euro²⁹. Kjo shumë ishte sa 3.1% e shpenzimeve totale buxhetore të vitit 2020, prej 536 miliardë lekësh (4.3 miliardë euro)³⁰.

Nga totali i fondeve për përballimin e efekteve të pandemike prej 16,5 miliardë lekësh (134 milionë euro), vetëm 3,1 miliardë lekë (25,2 milionë euro) u përdorën për financimin e nevojave shëndetësore që krijoi pandemia, ndërsa 13,5 miliardë lekë (11 milionë euro) u përdorën për mbështetje të ekonomisë nëpërmjet dy paketave të ndihmës³¹.

Tabela 1³²

Shpenzimet publike buxhetore dhe ato të dedikuara për shëndetësinë më 2020	Shpenzime fakt 2020 në milionë lekë
Buxheti i shtetit	536,500
Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë	67,862
- <i>Spektori i shëndetësisë</i>	38,700
- <i>Spektori i Mbrojtjes Sociale</i>	29,100
Shpenzime për krizën shëndetësore të COVID -19	3,100

Tabela 1³³- Shpenzimet publike buxhetore të dedikuara për shëndetësinë gjatë vitit 2020

FONDET PËR PËRBALLIMIN E KRIZËS SHËNDETËSORE SA 0.58 % E BUXHETIT 2020

Gjatë vitit 2020, fondet për përballimin e krizës shëndetësore ishin 3,1 miliardë lekë³⁴ (25,2 milionë euro) ose vetëm sa 0,58 për qind e shpenzimeve totale buxhetore prej 536 miliardë lekësh³⁵ (4,3 miliardë euro).

²⁹(me kursin mestar të këmbimit Euro lekë =123)

³⁰<https://financa.gov.al/paketa-e-projektligjit-te-buxhetit-faktik-2020/>

³¹<https://financa.gov.al/paketa-e-projektligjit-te-buxhetit-faktik-2020/>

³²<https://financa.gov.al/paketa-e-projektligjit-te-buxhetit-faktik-2020/>: <https://www.shendetesia.gov.al/tabelat-e-raportimit-per-intervalet-kohore-3-muaj-9-muaj-dhe-vjetore-si-dhe-relacionet-perkatese/>

³³<https://financa.gov.al/paketa-e-projektligjit-te-buxhetit-faktik-2020/>: <https://www.shendetesia.gov.al/tabelat-e-raportimit-per-intervalet-kohore-3-muaj-9-muaj-dhe-vjetore-si-dhe-relacionet-perkatese/>

³⁴<https://financa.gov.al/paketa-e-projektligjit-te-buxhetit-faktik-2020/>:

³⁵<https://www.shendetesia.gov.al/tabelat-e-raportimit-per-intervalet-kohore-3-muaj-9-muaj-dhe-vjetore-si-dhe-relacionet-perkatese/>

Gjithashtu, fondet e shpenzuara për krizën shëndetësore ishin sa 4.6% e buxhetit faktik të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2020 dhe sa 8% e totalit të fondeve³⁶ që financuan shëndetësinë³⁷ më 2020.

Në vitin 2020 buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë ishte 67,8 miliardë lekë (551 milionë Euro), nga të cilat 38,7 miliardë lekë (315 milionë euro) ose 57% shkuan për financimin e sistemit shëndetësor dhe pjesa tjetër prej 29 miliardë lekë (235 milionë euro), ose 43% e totalit, shkuan për Programin e Mbrojtjes Sociale (ndihma ekonomike, pagesa e papunësisë, kompensimi ish të përndjekurve)³⁸. Buxheti që financon nevojat shëndetësore në vitin 2020 ishte 2,2 miliardë lekë (17,8 milionë euro) ose 6.1% më i lartë se fakti i vitit 2019. Në vitin 2017 Qeveria “Rama 2” bashkoi Ministrinë e Mirëqenies dhe Mbrojtjes Sociale me Ministrinë e Shëndetësisë, dhe për shkak të funksioneve të reja, buxheti total për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është më i lartë pas vitit 2017.

Baza ligjore dhe detajimi i Fondeve Buxhetore të akorduara për masat anti-COVID 19 më 2020, pa përfshirë garancitë sovrane³⁹

Nëpërmjet tri akteve normative të miratuara gjatë vitit 2020 janë bërë ndryshime në fondet e planifikuara në ligjin e Buxhetit Nr.88/2019 “Për Buxhetin e vitit 2020”, në zërin e Fondit Rezervë të buxhetit të shtetit, me qëllim përdorimin e tyre për përbalimin e situatës së vështirë të krijuar si pasojë e pandemisë COVID-19.

Aktet kishin për qëllim përditësimin e shpenzimeve buxhetore me paketat e ndihmës për nxitjen e ekonomisë dhe për miratimin e fondeve shtesë, me të cilat do të bliheshin pajisje mbrojtëse për mjekët, pajisje dhe aparatura për spitalet.

Këto ndryshime paraqiten si më poshtë vijon:

Me Aktin Normativ Nr. 6 datë 21.03.2020 “Për disa ndryshime në ligjin Nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Fondi Rezervë u rishikua në masën 9.2 miliard lekë (74.7 milionë euro), ndërkohë që Neni 7 përcakton përdorimin e tij si më poshtë:

- 1.700 miliardë lekë (13,8 milionë euro) për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme;
- 6,500 milionë lekë (52 milionë euro) si kontigjencë për paketën sociale anti-COVID 19;
- 1 000 milionë lekë (8,1 milionë euro) për emergjenca te tjera në kuadër të masave anti-COVID 19.

³⁶Totali i fondeve buxhetore përfshin edhe ndihmat e huaja

³⁷<https://www.shendetesia.gov.al/tabelat-e-raportimit-per-intervalet-kohore-3-muaj-9-muaj-dhe-vjetore-si-dhe-relacionet-perkatese/>

³⁸<https://www.shendetesia.gov.al/tabelat-e-raportimit-per-intervalet-kohore-3-muaj-9-muaj-dhe-vjetore-si-dhe-relacionet-perkatese/>

³⁹<https://www.financa.gov.al/projektbuxheti-2021/relacioni>

Me Aktin Normativ Nr.15 datë 15.04.2020 "Për disa ndryshime në ligjin nr.88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar", Fondi Rezervë u rishikua në masën 16,2 miliard lekë, ndërkohë që neni 2 i tij përcakton përdorimin si më poshtë:	
➤	1700 milionë lekë (13,8 milionë euro) për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme.
➤	13,500 milionë lekë (109 milionë euro) si kontigjencë për paketën sociale anti-COVID 19.
➤	1 000 milionë lekë (8,1 milionë euro) për emergjenca të tjera në kuadër të masave anti-COVID 19.
Me Aktin Normativ Nr.28 datë 02.07.2020 "Për disa ndryshime në ligjin Nr. 88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar", përdorimi i Fondit Rezervë është përcaktuar si më poshtë:	
➤	2700 milionë lekë (22,3 milionë euro) për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme.
➤	13,500 milionë lekë (109 milionë euro) si kontigjencë për paketën sociale anti-COVID 19.
Fondi "Kontigjenca për paketën sociale anti-COVID 19" i planifikuar në masën 13,5 miliardë lekë, është akorduar:	
➤	Në masën 12,3 miliardë lekë (100 milionë euro) si ndihmë financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë (114 mijë euro);
➤	Në masën 1,031 miliardë lekë (8,6 milionë euro) si fond shtesë për skemën e Ndhmës Ekonomike;
➤	Në masën 118 milionë lekë (963 mijë euro) si fond shtesë për skemën e Papunësisë.
Në mënyrë të përmbledhur fondet buxhetore të akorduara gjatë vitit 2020, në kuadër të masave anti-COVID19 paraqiten si më poshtë:	
➤	Fondi "Kontigjencë për Paketën Sociale anti-COVID 19" në masën 13,500 milionë lekë (109 milionë euro).
➤	Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit (Emergjenca të tjera).
➤	Në kuadër të masave anti-COVID 19 629,4 milionë lekë (5,1 milionë euro).
➤	Alokime me VKM në MSHMS 2,5 miliardë lekë (20,3 milionë euro).
Totali i buxhetit	16,6 miliardë lekë (135 million Euro)

FONDI PËR KRIZËN SHËNDETËSORE 2020, 38% PAJISJE MBROJTËSE PËR MJEKËT, TË TJERAT APARATURA DHE PAJISJE PËR SPITALET

Në kuadër të pandemisë COVID-19, qeveria shqiptare alokoi për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale një buxhet të dedikuar për menaxhimin e epidemisë dhe forcimin e sistemit shëndetësor, në vlerën mbi 2,5 miliardë lekë (17 milionë euro) nga buxheti i shtetit për vitin 2020. Kësaj shume iu shtuan edhe rreth

507 milion lekë (4.1 milionë euro), ndihma kryesisht nga organizata ndërkombëtare në pajisje mjekësore, materiale mbrojtëse dhe medikamente⁴⁰.

- Një shumë prej 1,2 miliardë lekësh (9,7 milionë euro) ose 38% e fondeve totale për krizën shëndetësore 2020 prej 3,1 miliardë lekësh (25,5 milionë euro) shkuan për të garantuar mjetet e mbrojtjes personale për stafin shëndetësor në të gjithë nivelet e sistemit shëndet publik.
- 160 milionë lekë (1,3 milionë euro) bënë të mundur që përveç dy spitaleve COVID të Shërbimit Infektiv në QSUT (COVID 1) dhe Spitalit Universitar Shefqet Ndroqi (COVID 2), të bëhen gati edhe dy spitale COVID: Spitali COVID 3 në godinën e ish-kirurgjisë në QSUT, me një kapacitet prej 125 shtretërish; si dhe Spitali COVID 4 në godinën e ish-Universitetit Kristal, me kapacitet prej 108 shtretërish. Është investuar në forcimin e kapaciteteve të terapisë intensive dhe sub-intensive, duke dedikuar 500 shtretër, 80% e tyre me linja oksigjeni dhe ku gjysma e tyre janë kapacitete të reja në sistem (COVID 3 dhe 4).
- 764,9 milionë lekë (6,2 milionë euro) u përdorën për pajisjen me aparatura të reja spitalet COVID dhe njësitë e terapive intensive në spitalet rajonale, përkatësisht 100 shtretër të rinj reanimacioni, 265 monitorë multiparametrik, 134 respiratorë invazive dhe jo-invazive, si dhe janë alokuar fondet për blerjen e pajisjeve të rënda bio-mjekësore për shërbimin e imazherisë dhe diagnostikues.
- 50 milionë lekë (406 mijë euro) u përdorën për të siguruar terapinë e mjekimit me medikamentet sipas protokolleve të shërbimeve spitalore të njëjta me vendet e tjera pa asnjë mungesë.
- 80 milionë lekë (650 milionë euro) u përdorën të garantuar terapinë me plazmë sipas protokolleve.
- 55 milionë lekë (447 mijë euro) u përdorën për të rritur kapacitetet laboratorike të testimit, duke hapur një laborator të ri në QSUT dhe duke rritur kapacitetet e testimit në laboratorët e ISHP.
- 240 milionë lekë (1,9 milionë euro) u përdorën për të fuqizuar shërbimin e urgjencës para-mjekësore me blerjen e 36 autoambulancave të reja.
- 141 milionë lekë (1,1 milionë euro) u përdorën për vaksinimin më 2020 ndaj gripit të stinës për kategoritë e rrezikuara si të sëmurët kronikë, personelin

⁴⁰<https://www.financa.gov.al/projektbuxheti-2021/relacioni>

shëndetësor, mësues, edukatorët, fëmijët 2-5 vjeç, të moshuarit, për 370 mijë doza vaksinash, ose 4 herë më shumë se 2019.

- 56 milionë lekë (449 mijë euro) janë investuar për rikonstruksionin e Pediatriisë Infektive në QSUT në vlerën 41 milionë lekë dhe rikonstruksionin e Reanimacionit të Spitalit Rajonal Vlorë.
- Gjithashtu, qeveria shqiptare u angazhua financiarisht për sigurimin e vaksinës së sigurt dhe efikase kundër COVID-19 nëpërmjet mekanizmit ku aderohet mbi 90 shtete COVAX Facility. Në vitin 2020 nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është kryer gjithashtu pagesa prej 430 milionë lekë (3,4 milionë euro) për kuotën në bazë të marrëveshjes me COVAX.
- 76 milionë lekë (617 mijë euro) u akorduan për personelin shëndetësor në vijën e parë të luftës, bazuar në vendimin për shpërblimin financiar 1,000 euro mbi pagën mujore për personelin shëndetësor dhe 500 euro mbi pagën për stafin mbështetës.

Si u përdor fondi 3,1 miliardë lekë për emergjencën shëndetësore, sipas zërave dhe produkteve më 2020	Të dhënat në lekë)	në Euro
Pajisje mbrojtëse për mjekët, veshje dhe maska	1,200,000,000	9,756,098
Blerja e vaksinave anti-COVID	1,200,000,000	9,756,098
Blerje të pajisjesh për spitalet COVID, monitorë, respiratorë, etj.	764,900,000	6,218,699
Blerja e 36 autoambulancave	240,000,000	1,951,220
Rikonstruksion i 4 spitaleve COVID	160,000,000	1,300,813
Blerja e vaksinave për gripin normal	141,000,000	1,146,341
Trajtimi me plazmë	80,000,000	650,407
Shpërblimi, bonusi për stafin mjekësor	76,000,000	617,886
Medikamente, sipas protokolleve për trajtimin e COVID në spitale	50,000,000	406,504
Rikonstruksion i reanimacionit të spitalit Vlorë	41,000,000	333,333
Totali	3,188,000,000	5,918,699
<i>Burimi: Ministria e Financave: projektbuxheti 2021, Ministria e shëndetësisë: Raporti i Monitorimit të buxhetit 2020</i>		

6. KOSTO E PLANIFIKUAR E MENAXHIMIT TË PANDEMISË NË 2021

PËR TË GJITHË VITIN 2021, KOSTO TOTALE E PLANIFIKUAR E MENAXHIMIT TË PANDEMISË 7 MILIARDË LEKË (57 MILIONË EURO)

Fondi total për menaxhimin e pandemisë nga buxheti i shtetit për vitin 2021 është 7 miliardë lekë (57 milionë euro)⁴¹. Nga kjo shumë, 6 miliardë lekë (49 milionë euro) u përcaktuan si shpenzime në buxhetin 2020, ndërsa 1 miliard lekë u shtuan në Aktin Normativ Nr.26 datë 22.06.2021 për ndryshimin e buxhetit 2021.

Shuma prej 6 miliardë lekësh (48,7 milionë euro), që u miratua në buxhetin fillestar, kishte për qëllim financimin e nevojave të mëposhtme:

- Marrjen e masave për ruajtjen e vazhdimësisë së shërbimeve spitalore, ofrimin e shërbimeve bazuar në protokollat mjekësore COVID-19, adaptimin e shpejtë dhe përshtatjen e shërbimeve ndaj kërkesave të reja që mund të paraqiten.
- Ri-pozicionimin e shërbimeve spitalore të aksesueshme fizikisht për popullatën që ka nevojë për përdorimin e tyre dhe vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit spitalor të urgjencës në kushtet e ashpërsimit të pandemisë.
- Vlerësimin dhe përditësimin e protokolleve të hartuara për referimin dhe transportin nga urgjenca para-mjekësore në strukturat spitalore dhe zgjerimi i skuadrave të lëvizshme dhe të dedikuara që ofrojnë shërbime në banesë dhe në bashkëpunim me mjekët e familjes.
- Hartimi i protokolleve për trajtim në banesë nga QKUM (skuadrat e terrenit), në bashkëpunim me mjekët e familjes, për pacientët që nuk kanë nevojë për hospitalizim dhe shtim të mëtejshëm të kapaciteteve të burimeve njerëzore, duke rekrutuar dhe trajnuar staf shtesë.

Shtim të kapaciteteve, përfshirë flotën e autoambulancave, kapacitetet në sistemet e informacionit, etj.⁴²

- Fuqizimi i rolit të mjekut të përgjithshëm dhe të familjes, mjekut specialist të Qendrave Shëndetësore dhe infermierit në Kujdesin Parësor në diagnostikim dhe ndjekje të pacientëve me COVID-19 dhe pacientëve të tjerë kronikë me probleme për lëvizje/dalje nga banesat e tyre, nëpërmjet platformave digjitale si Skype, Ëhatsapp, etj., ose nëpërmjet vizitave në banesë, kur mjeku e gjykon të arsyeshme, veçanërisht për personat me risk të lartë.

⁴¹<https://www.financa.gov.al/projektbuxheti-2021/relacioni>

⁴²<https://www.financa.gov.al/projektbuxheti-2021/relacioni>

- Ofrimin e kujdesit shëndetësor në Shtëpitë e të Moshuarve (azile), në përputhje me nevojat e tyre, përmes bashkëpunimit me mjekët e përgjithshëm dhe mjekët e familjes dhe në rastet kur është e nevojshme edhe me mjekët specialistë të poliklinikave (QSHS) dhe infermierëve.
- Fuqizimin e shërbimit infermieristik territorial për të fuqizuar asistencën (kujdesin) në banesë për të sëmurët kronikë, pacientët me paaftësi fizike (tetraplegjikë, paraplegjikë, të verbrit, invalidët e përhershëm), pacientët me probleme të shëndetit mendor dhe ata që për arsye të pamundësisë së lëvizjes janë të izoluar në shtëpi.
- Ofrimin e konsultave online për pacientët kronikë në gjendje të stabilizuar, me qëllim kufizimin e grumbullimit të tyre ambientet e strukturave shëndetësore.
- Rritjen e kapaciteteve laboratorike dhe ofrimin e panelit të analizave të nevojshme, si dhe testimin për RT–PCR SARS COV 2 edhe në sistemin spitalor rajonal.
- Në kuadër të rritjes së kapaciteteve për përballimin e situatave të krijuara nga COVID-19 dhe uljen e përhapjes së infeksionit, do të garantohet furnizimi i pandërprerë i stafit mjekësor me të gjitha mjetet mbrojtëse personale të nevojshme, duke përfshirë: maske respiratorë, syze mbrojtëse, doreza, përparëse me një përdorim dhe të padepërtueshme, kapuç kirurgjikal koke, veshjet mbrojtëse Tyvek, etj.
- Me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit në institucionet spitalore, do t'i kushtohet gjithashtu rëndësi e veçantë: menaxhimit të mbetjeve infektive; zbatimit të rreptë të protokolleve mbrojtëse nga stafi mjekësor; kontrollit të infeksionit mjedisor nëpërmjet dezinfektimit të saktë dhe të shpeshtë të ambienteve të kujdesit shëndetësor.

Qeveria me Aktin Normativ Nr.26 datë 22.06.2021 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021, i ndryshuar” autorizoi edhe 1 miliard lekë (8 milionë euro), të cilat do të shpenzohen për blerjen e vaksinave.

Bazuar në strategjinë e vaksinimit për të arritur imunizimin e të gjithë popullatës, është vendosur si objektiv vaksinimi i 2,2 milionë personave, për të cilët nevojiten 4,4 milionë doza vaksina. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, deri në qershor 2021, qeveria shqiptare ka nënshkruar kontrata për sigurimin e 2,9 milionë dozave vaksinave: 1,2 milionë doza nga kontrata COVAX për një periudhë 3-vjeçare, 1,6 milionë doza nga kontrata që kryesisht përfundojnë brenda vitit 2021, si dhe 236,134 doza vaksina donacione. Ndërkohë që për përmbushjen e objektivit të imunizimit ndaj COVID-19 kërkohen dhe 1,1 milionë doza të tjera vaksine, ku duke marrë

parasysh çmimet e vaksinave, do të kërkonte një shtesë në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë prej 1 miliard lekë (8 milionë euro), të dedikuar për vaksinat⁴³.

Shtesa e fondeve për blerjen e vaksinave u gjenerua nga shkurtimet që u bënë në buxhetin total të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për këtë vit me Aktin Normativ Nr.26, datë 22.06.2021. Tabelat që shoqërojnë ndryshimet në buxhet, të miratuara tashmë edhe nga Komisioni i Ekonomisë në Kuvend, i kanë shkurtuar me 1 miliard lekë ose (8,1 milionë euro) fondet për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Sipas ndryshimeve të buxhetit me aktin normativ të qershorit 2021, fondet totale për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale arritën në 70.4 miliardë lekë (572 milionë euro) në qershor 2021, nga 71.4 miliardë lekë (580 milionë euro) që ishin me ndryshimet në aktin normativ të majit 2021⁴⁴.

MARS 2020-QERSHOR 2021, FINANCIMET BUXHETORE PËR MENAXHIMIN E KRIZËS - SHËNDETËSORË COVID-19, SA 0.9 % E TOTALIT TË SHPENZIMEVE

Nga marsi i vitit të kaluar deri në qershor të vitit 2021, qeveria ka akorduar për përballimin e krizës shëndetësore që krijoi pandemia 10,1 miliardë lekë (82 milionë euro), nga të cilat 3,1 miliardë lekë (26 milionë euro) tashmë janë shpenzuar në buxhetin e vitit 2020 dhe 7 miliardë lekë (57 milionë euro) janë autorizuar për shpenzime gjatë këtij viti⁴⁵. Vlera e shpenzimeve për përballimin e pandemisë nga sistemi shëndetësor ishte sa 0.9% e shpenzimeve totale buxhetore të dy viteve të fundit. Gjatë vitit 2020 shpenzimet totale nga buxheti i shtetit ishin 536 miliardë lekë (4.34 miliardë euro), ndërsa në këtë vit plani i shpenzimeve buxhetore, sipas Aktit Normativ Nr.26, datë 22.06.2021, do të jenë 610 miliardë lekë (5 miliardë euro). Shpenzimet totale buxhetore në dy vitet së bashku (2020 dhe 2021) arrijnë një vlerë të përgjithshme 1,1 triliardë lekë ose 9,3 miliardë euro. Fondet e përballimin e krizës shëndetësore përgjatë 2020-2021, prej rreth 82 milionë eurosh, janë vetëm 0,9% e vlerës totale të shpenzimeve prej 9,3 miliardë euro⁴⁶.

Shpenzimet për përballimin e krizës shëndetësore ishin 12,6 % e totalit të buxhetit të sektorit të shëndetësisë për dy vitet 2019-2020. Të dhënat buxhetore tregojnë se për vitin 2020-2021 fondet për financimin e shëndetësisë ishin gjithsej 80,1 miliardë lekë (658 milionë euro), nga të cilat 38,7 miliardë lekë (315 milionë euro) u shpenzuan në vitin 2020 dhe 40,1 miliardë lekë (326 milionë euro) planifikohen të shpenzohen këtë vit⁴⁷.

⁴³<http://www.parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/54619>

⁴⁴<https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/06/Akti-Normativ-i-Buxhetit-2021-nr.26-date-22.06.2021.pdf>

⁴⁵<https://www.financa.gov.al/projektbuxheti-2021/relacioni>

⁴⁶<https://financa.gov.al/statistika-fiskale-mujore/>

⁴⁷<https://www.shendetesia.gov.al/tabelat-e-raportimit-per-intervalet-kohore-3-muaj-9-muaj-dhe-vjetore-si-dhe-relacionet-perkatese/>

Banka Botërore, në një vlerësim të posaçëm për kapacitetet e sistemeve shëndetësore në Ballkanin Perëndimor, konstaton se edhe përpara shpërthimit të COVID-19, sistemet shëndetësore në Shqipëri, dhe në përgjithësi në Ballkan, përballeshin me vështirësi kritike në financim dhe në realizim të shërbimeve. Shpenzimet për frymë për sistemet shëndetësore janë ndjeshëm më të ulëta se mesatarja e BE-së dhe mënyra me të cilën shpenzohen fondet e pakta është jo-efikase ose jo e harmonizuar me profilin e sëmundshmërisë⁴⁸.

Sipas Bankës Botërore, shpenzimet kombëtare për frymë për shëndetin në Shqipëri janë 307 dollarë, në Bosnjë 681 dollarë, në Malin e Zi 508 dollarë, në Maqedoninë e Veriut 539 dollarë dhe në Serbi 812 dollarë. Ndërkohë që mesatarja e BE është 3,127 dollarë për frymë. Në këto shuma përfshihen edhe shpenzimet nga xhepi, për shembull një shqiptar nga 307 dollarë që shpenzon mesatarisht në vit për shëndetin, 45% e paguan nga xhepi⁴⁹ dhe pjesën tjetër e ofron shteti nëpërmjet shërbimeve dhe rimbursimit të medikamenteve. Shqipëria ka nivelin më të lartë të pagesave nga xhepi, pasi Bosnja e ka këtë tregues 29%, Mali i Zi 39.6%, Maqedonia e Veriut 39.6% dhe Serbia 38.3%.

COVID-19, MARS 2020-MAJ 2021 PROKUROHEN 36 MILIONË EURO, DISBURSOHEN VETËM 54%

Nga marsi i vitit 2020 deri në maj të vitit 2021 institucionet publike në vend kanë prokuruar një vlerë prej 4,4 miliardë lekësh (36 milionë euro) për përballimin e pandemisë COVID-19, por thesari i shtetit ka disbursuar ndaj kontraktorëve vetëm 2,4 miliardë lekë (19,5 milionë euro) ose 55 për qind të shumës së vënë në dispozicion për blerjet⁵⁰.

59 kompani lidhën kontrata me qeverinë për të ofruar mallrat dhe shërbimet që nevojiteshin për përballimin e pandemisë. 12 prej tyre ishin sekrete dhe përbënin 20 për qind të totalit të kontratave të shpallura fituese.

Gjithashtu, 11 kontrata të tjera, që përbënin 20 për qind të totalit, nuk e kishin vlerën totale të prokuruar, por vetëm çmimin për njësi⁵¹.

Në renditje sipas Vlerës së Kontratës së Fituar në Shëndetësi, për kontraktim blerje, investim apo porosi për COVID-19, mars 2020 – maj 2021, biznesi i parë më i kontraktuar në vlerë është shoqëria GTS-Gazra Teknike Shqiptare shpk, e cila siguroi mbi 2,4 miliardë lekë (19.5 milionë euro) fonde publike, ose 47 për qind të fondeve totale të gjetura në listën e Agjencisë së Prokurimeve Publike. GTS-Gazra Teknike Shqiptare ishte burimi kryesor i furnizimit të spitaleve COVID-19 me oksigjen.

⁴⁸<https://documents1.worldbank.org/curated/en/941251597066127352/pdf/Albania-Emergency-COVID-19-Response-Project.pdf?fbclid=IwAR1mzeGADNVbvJGSoXCPcMc2qWyKGrnz-3JBs8ldo9UNXjEtbo5C790w7JI>

⁴⁹<https://data.worldbank.org/indicator/SH.XPD.OOPC.CH.ZS>

⁵⁰<http://ndiqparate.al/2021/06/07/biznese-kontraktore-shendetesi-covid-19-mars-2020-maj-2021/>

⁵¹<http://ndiqparate.al/2021/06/07/biznese-kontraktore-shendetesi-covid-19-mars-2020-maj-2021/>

Kontraktuesi i dytë më i madh ishte kompania Evita me 627 milionë lekë (5,1 milionë Euro) dhe e treta Intermed me 384 milionë lekë (3,1 milionë euro). 59 kompani u kontraktuan nga institucionet e shëndetësisë për furnizimin e pajisjeve mjekësore për COVID (pajisje për spitale, oksigjen dhe barna konform protokolleve anti-Covid, etj)⁵², nga të cilat vetëm 39 prej tyre ose 66% morën pagesat gjatë periudhës mars 2020 - maj 2021. Të dhënat vlejné për kompanitë që i kanë kontratat me vlera të publikuara.

Nga 2,4 miliardë lekë pagesa (19.5 milionë euro) që u bënë nga thesari gjatë mars 2020 - maj 2021, mbi 1 miliard lekë (8.1 milionë euro) ose 41% e totalit iu dhanë kompanisë GTS që siguroi furnizimin me oksigjen të spitaleve. Kompania Evita ishte e dyta për sasinë më të madhe të disbursimeve, me 281 milionë lekë (2,3 milionë euro) dhe Euromed e treta me 137 milionë lekë (1,1 milionë euro)⁵³.

Renditja e kompanive sipas vlerave të fituara në tendera, Institucionet e Shëndetësisë Mars 2020 - Maj 2021	
COVID -19, institucionet e Shëndetësisë Mars 2020 - Maj 2021	Tenderime Vlera e fituar Pa TVSH
GTS-Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k.	2,084,154,082
EVITA SHPK	627,510,300
INTERMED SHPK	384,590,308
Biometric Albania SHPK	203,645,500
MESSER ALBAGAZ SHPK	196,495,440
EUROMED SHPK & Farma Net Albania SHPK	189,585,000
OES Distrimed SHPK	185,067,400
EUROMED SHPK	133,247,145
EUROVIA shpknj	101,430,000
Farma Net Albania	92,384,000
Gen-Alb Farma SHPK	84,935,000
FEDOS SHPK	57,340,180
XPERT SYSTEMS	40,155,500
ECO RICIKLIM	9,811,200
KRIJON SHPK	7,086,000
Aquarius Medical	5,884,542
Intelligent Building Solution (I.B.S.) - R & T	5,000,000
ALPEN PULITO	4,242,854
4 S	4,150,750
MEDI-TEL SHPK	2,730,112
LOERMA	2,647,259

⁵²<https://www.financa.gov.al/pagesat-e-kryera-2021/>

<https://www.financa.gov.al/pagesat-e-kryera-2020/>

⁵³<http://ndiqparate.al/2021/06/07/biznese-kontraktore-shendetesi-covid-19-mars-2020-maj-2021/>

Burimi: <https://www.financa.gov.al/pagesat-e-kryera-2021/>

GREEMED SHPK	2,072,000
JUPITER GROUP	1,525,000
SULLOLLARI-KLIMA	1,195,750
Nertil Shehaj	600,000
Jimi	545,900
ARTEO 2018	319,000
MOTO-MANIA	275,000
CFO PHARMA	239,000
Erlind Asllani	180,000
FLORFARMA SHPK	146,300
EURO MEGA 2010	99,900
MAJ-ALB	14,000
Human Vaccine LLC	vaksina
KEYMEN İLAC SANAYI VE TICARET ANONİM SİRKETİ	vaksina
GAVI Alliance	vaksine
Pfizer export bv	vaksina
Biometric Albania SHPK	sekrete
EURO MEGA 2010	sekrete
Farma Net Albania SHPK & EUROMED SHPK	sekrete
FEDOS SHPK	sekrete
Genius SHPK	sekrete
KRIJON SHPK	sekrete
MEDICAMENTA SHPK	sekrete
MEGAPHARMA SHPK	sekrete
OES Distrimed SHPK	sekrete
Rejsi FARMA SHPK	sekrete
T B S 96 SHPK	sekrete
TEOREN	sekrete
Aldosch-Farma SHPK	ofruar vlera çmim për njësi
EDNA - FARMA SHPK	ofruar vlera çmim për njësi
INCOMED SHPK	ofruar vlera çmim për njësi
LEKLI SHPK & MEGAPHARMA SHPK	ofruar vlera çmim për njësi
MEDICAMENTA SHPK	ofruar vlera çmim për njësi
Megapharm - DELTA PHARMA - AL - incomed	ofruar vlera çmim për njësi
MEGAPHARMA SHPK	ofruar vlera çmim për njësi
MEGAPHARMA SHPK & ALBANIA NEË PHARM SHPK	ofruar vlera çmim për njësi

Pegasus SHPK	ofruar vlera çmim për njësi
Rejsi FARMA SHPK	ofruar vlera çmim për njësi
TRIMED SHPK	ofruar vlera çmim për njësi
TOTALI	4,429,304,422
<i>Burimi: Ndiqparate.al⁵⁴</i>	

Pagesa Thesari për Furnizime Covid-19 kompani shqiptare renditje sipas vlerave Mars 2020 - Maj 2021	
Kompania	Pagesa totale COVID transaksione thesarit (Lekë)
GTS-Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k.	1,008,041,481
EVITA SHPK	281,187,447
EUROMED SHPK	137,462,265
Biometric Albania SHPK	126,413,784
EUROVIA shpknj	121,716,000
MESSER ALBAGAZ SHPK	106,901,983
Gen-Alb Farma SHPK	101,922,000
INTERMED SHPK	95,850,400
OES Distrimed SHPK	87,174,000
Farma Net Albania SHPK	65,179,014
INCOMED SHPK	40,719,713
Incomed	40,719,713
MEGAPHARMA SHPK	39,217,794
TRIMED SHPK	34,486,047
XPERT SYSTEMS	19,866,600
Rejsi FARMA SHPK	19,046,972
EDNA - FARMA SHPK	14,544,455
ECO RICIKLIM	9,811,200
MEGAPHARMA SHPK	9,666,250
ALBANIA NEË PHARM SHPK	9,544,750
T B S 96 SHPK	8,340,000
KRIJON SHPK	7,086,000
FLORFARMA SHPK	7,021,825
Aldosch-Farma SHPK	6,094,165

⁵⁴<http://ndiqparate.al/2021/06/07/biznese-kontraktore-shendetesi-covid-19-mars-2020-maj-2021>; përpunimi autorët

4 S	4,980,900
Aquarius Medical	4,799,449
FEDOS SHPK	4,528,200
Genius SHPK	3,961,536
MEDI-TEL SHPK	3,268,636
LOERMA	2,511,760
EURO MEGA 2010	2,134,836
Rejsi FARMA SHPK	1,255,466
LEKLI SHPK &	1,224,133
ALPEN PULITO	1,207,772
TEOREN	1,020,000
DELTA PHARMA	981,072
MEDICAMENTA SHPK	513,000
MOTO-MANIA	219,840
CFO PHARMA	110,400
Pegasus SHPK	35,832
TOTALI	2,430,766,690
Burimi: Ndiqparatë.al ⁵⁵	

⁵⁵<http://ndiqparate.al/2021/06/07/biznese-kontraktore-shendetesi-covid-19-mars-2020-maj-2021/>; përpunimi autorët

7. KONKLUZIONE

- Është e dukshme që rritja e shpenzimeve buxhetore dhe borxhit publik, me qëllimin kryesor luftimin e pasojave të pandemisë në ekonomi dhe ruajtjen e shëndetit të popullatës, nuk u shfrytëzua për të alokuar më shumë fonde për të përballuar pasojat që pandemia solli në shëndetin e njerëzve.
- Megjithëse qeveria rriti shpenzimet buxhetore me ritmet më të larta të dekadës përgjatë dy viteve të fundit 2020 - 2021, përkatësisht me 9 dhe 13.3%, fondet publike për sektorin e shëndetësisë u rritën me ritme më të ulëta 6% dhe 3.4%.
- Në vitin 2020, shpenzimet për shëndetësinë, në raport me totalin e shpenzimeve buxhetore, ranë me 0.2 pikë përqindje në krahasim me vitin e mëparshëm, duke zbritur në 7.2% të totalit.
- Për vitin 2021, ndonëse vala pandemike ishte shumë e fortë në muajt e parë të vitit dhe vendi ka hyrë në një periudhë të re me raste të rritura të raportuara me COVID-19, shpenzimet e planifikuara për sektorin e shëndetësisë janë 6.6% e totalit, me rënie prej 0.6% në krahasim me vitin 2020, për shkak të rritjes shumë më të lartë të shpenzimeve totale, në raport me ato për shëndetësinë.
- Shpenzimet buxhetore po kanalizohen drejt projekteve jo-emergjente, si investimet në infrastrukturë dhe në financimin e kontratave koncesionare, duke lënë sektorin e shëndetësisë pa vëmendjen e nevojshme në këtë periudhë të pazakontë.
- Nga fondet e dedikuara për krizën shëndetësore, një pjesë e madhe e tyre shkuan për pajisje mbrojtëse për stafet mjekësore dhe shumë pak për të përmirësuar logjistikën dhe shërbimet ndaj pacientëve. Për pasojë, Shqipëria u përball me normën më të lartë të vdekshmërisë shtesë gjatë vitit 2020.
- Ecuria e deritanishme tregon se pandemia dhe zhvillimet demografike do të ushtrojnë presion në periudhë afatgjate në sektorin e shëndetësisë.
- Në terma afatshkurtër, sektori shëndetësor duhet të vijojë luftën frontale ndaj COVID-19, pasi pandemia nuk e ka përfunduar ciklin e saj dhe parashikimet për shtrirjen e saj në kohë nuk janë të qarta.
- Në terma afatgjatë, shërbimet shëndetësore do të përballen me një fluks kërkesash për trajtim, pasi COVID-19 ka lënë një barrë të lartë sëmundjesh në diagnoza të tjera, të tilla si: çrregullimet e zemrës, artritet, diabeti etj.

8. REKOMANDIME

- Qeveria duhet të ndërtojë një strategji afatgjate dhe të qëndrueshme për sektorin e shëndetësisë, i cili në vitet në vijim duhet të përballet edhe me barrën e lartë të sëmundjeve, që do të vijë natyrshëm edhe nga plakja e popullsisë.
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të shtojë stafet mbështetëse në spitalet COVID-19 të tillë si sanitare, psikologë, infermierë dhe reanimatorë, dhe pajisje diagnostikuese të tilla si grafi dixhitale të lëvizshme, respiratorë, Ecmo (një pajisje që ndihmon në rikthimin në jetë të pacientëve të intubuar). Duhet më shumë investime në pajisjet që shërbejnë për dhënien e ndihmës së parë gjatë transportit, të tilla siç janë ventilatorët pulmonarë të prodhuar posaçërisht për ventilimin e pacientit gjatë transportit ose gjatë urgjencës jashtë spitalit.
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Instituti i Shëndetit Publik duhet të rrisë më tej kapacitet e gjurmimit, testimit dhe pajisjeve laboratorike, për të mbajtur nën kontroll përhapjen e pandemisë.
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale duhet të rrisë kapacitetet në shërbimin parësor për rritjen e cilësisë në trajtimin e hershëm të të sëmurëve.
- Të kanalizohen më shumë fonde buxhetore në sektorin e shëndetësisë, në rritjen e kapaciteteve spitalore si në burime njerëzore dhe pajisje mjekësore.
- Shqipëria ka hapësira për rritjen e shpenzimeve buxhetore në sektorin e shëndetësisë, pasi në vitin 2020, vendi kishte shpenzimet nominale për banor në sektorin e shëndetësisë, vetëm 297 euro, duke u renditur vendi i dytë me këtë kategori shpenzimesh më të ulët në Evropë, pas Maqedonisë së Veriut (255 euro) dhe shumë më pak sesa mesatarja e Bashkimit Evropian (27 vende) ku këto shpenzime janë 2,614 euro.
- Për arsyet e përmendura më lart, rekomandimi kryesor është që në terma afatshkurtër, të paktën deri në kapërcimin e emergjencës mjekësore, prioritetet e shpenzimeve të zhvendosen në sektorin e shëndetësisë.

BURIMET

- Realizimi i treguesve të monitorimit financiar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për 4 mujin e I-rë të vitit 2021; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Paketa e projektligjit faktik 2020; Ministria e Financave
- Projektbuxheti 2021, Relacioni; Ministria e Financave
- Në gjurmët e parave të Covid-19, Raport; shoqata Together for Life, mbështetur nga Fondacioni Ëestminster për Demokraci
- Baza e të dhënave të Shpenzimeve Globale; Organizata Botërore e Shëndetësisë
- Banka Botërore; Projekti i reagimit emergjent i Shqipërisë ndaj Covid-19
- Akt Normativ Nr. 26, Datë 23.6.2021 “Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Ligjin Nr.137/2020, “Për Buxhetin E Vitit 2021”, Të Ndryshuar; Kuvendi i Shqipërisë
- Treguesit demografik dhe Social; INSTAT
- Eurostat
- <https://documents1.worldbank.org/curated/en/941251597066127352/pdf/Albania-Emergency-COVID-19-Response-Project.pdf?fbclid=IwAR1mzeGADNVbvJGSoXCPcMc2qWyKGrnz-3JBs8ldo9UNXjEtbo5C790w7JI>
- <http://ndiqparate.al/2021/06/07/biznese-kontraktore-shendetesi-covid-19-mars-2020-maj-2021>; përpunimi autorët
- <https://financa.gov.al/paketa-e-projektligjit-te-buxhetit-faktik-2020/>
- <https://www.financa.gov.al/projektbuxheti-2021/relacioni>
- <http://ndiqparate.al/2021/06/07/biznese-kontraktore-shendetesi-covid-19-mars-2020-maj-2021/>
- <https://www.financa.gov.al/pagesat-e-kryera-2021/>
- <http://www.parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/54619>
- <https://financa.gov.al/ep-content/uploads/2021/06/Akti-Normativ-i-Buxhetit-2021-nr.26-date-22.06.2021.pdf>
- <https://www.financa.gov.al/projektbuxheti-2021/relacioni>
- <https://financa.gov.al/statistika-fiskale-mujore/>
- <http://instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martestat/publikimet/2020/treguesit-demografik%C3%AB-t4-2020/>
- <https://www.esap.online/observatory/docs/148/social-protection-and-inclusion-policy-responses-to-the-covid-19-crisis>

Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD) është organ publik i Mbretërisë së Bashkuar i dedikuar për të mbështetur demokracinë në mbarë botën. Duke vepruar ndërkombëtarisht, WFD punon me parlamentet, partitë politike dhe grupet e shoqërisë civile, si dhe me zgjedhjet për të ndihmuar shtetet të kenë sisteme politike më të drejta, më gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme.



www.wfd.org



@WFD_Democracy



@WestminsterFoundation



Fondacioni Westminster për Demokraci është një organ ekzekutiv publik i sponsorizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit.

